



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 191

dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 954, datë 5.9.2012	Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanati)..... 11397
Vendim i KM nr. 956, datë 9.5.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar..... 11399
Vendim i KM nr. 957, datë 19.12.2012	Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike..... 11415

VENDIM
Nr. 954, datë 5.9.2012

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË EKONOMISË KREATIVE (ARTIZANATI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pikat 3 e 4, 5, 6, 7, 8 e 9 të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit të Ekonomisë Kreative, me vlerë të përgjithshme 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një periudhë zbatimi prej 4 (katër) vjetësh, duke filluar nga viti 2013.

2. Për secilin nga vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, vlera e fondit do të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

3. Fondi i Ekonomisë Kreative, përveç fondeve nga Buxheti i Shtetit, të parashikuar si më sipër, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

4. Fondi i Ekonomisë Kreative ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e artizanatit, ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë. Në varësi të projektit konkurrues, të përgatitur nga aplikantët, skema mbulon nga 60% deri 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, brenda kufirit të lartpërmendur. Përfitimi i ndërmarrjeve artizanale nga mbështetja e programeve apo projekteve përmes kreditimit të lehtësuar, duke përdorur fonde nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga Fondi i Ekonomisë Kreative.

5. Projektet që përzgjidhen nga sektori i artizanatit, mbulojnë 3 nga fushat e mëposhtme:

a) Zhvillimi i produkteve të reja;

b) Marketingu i produktit;

c) Kualifikimi dhe ndërtimi i kapaciteteve menaxheriale të ndërmarrjes aplikuese.

6. Përfitojnë nga Fondi i Ekonomisë Kreative ndërmarrjet mikro dhe të vogla, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) Janë ndërmarrje, të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, të ndryshuar;

b) Kanë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit;

c) Prodhonë në Shqipëri produkte, të cilat aktualisht tregtohen brenda vendit, eksportohen jashtë ose krijojnë vende të reja pune;

ç) Propozojnë një sërë aktivitesh koherente në kuadër të Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanati), duke ndikuar më së shumti apo në mënyrë integrale, në aktivitetet e aplikuesit dhe proceset e krijimit të vlerave brenda territorit të vendit;

d) Demonstronë se aktivitetet që propozohen për mbështetje nga Fondi i Ekonomisë Kreative (Artizanati) janë të rëndësishme për zhvillimin e biznesit të tyre, duke treguar se ato kanë:

i) nevojë për t'u përmirësuar, gjë që do të preket nga aktivitetet e propozuara;

ii) një vlerësim për përfitimet e biznesit nga përmirësimi, në bazë të të cilit do të zhvillohen aktivitetet e propozuara;

iii) një plan biznesi ose një projekt, duke demonstruar sa më sipër, i cili do të integrohet dhe do të materializohet më tej nga aktivitetet e propozuara.

dh) Tregojnë që ato nuk kanë mundësi të vazhdojnë në mënyrë optimale pa asistencë;

e) Janë të afta për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara;



ë) Janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të projektit të propozuar para përfundimit të tij.

7. Për projektet që mund të përzgjidhen, duhet të identifikohen dhe të përshkruhen detyrimisht:

- a) qëllimi i projektit;
- b) kufizimi rajonal;
- c) veprimtaria zejtare/artizanale në rajon;
- ç) me hollësi veprimtaritë që do të kryhen;
- d) termat e referencës për të gjitha aktivitetet që duhen nënkontraktuar;
- dh) buxheti i detajuar, përfshirë burimet financiare dhe/ose të ardhurat;
- e) mënyra e menaxhimit të projektit, sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit;
- ë) rezultatet e pritshme;
- f) indikatorët e verifikueshëm.

8. Për qëllimet e këtij fondi, mund të merren në konsideratë vetëm produktet materiale zejtare/artizanale, me përjashtim të ushqimeve dhe pijeve.

9. Pagesa e subvencionit të bëhet në fund të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

10. Subvencioni nuk mund të jepet më tepër se një herë për të njëjtën ndërmarrje.

11. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për administrimin e Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanati). Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve sipas pikave 6 dhe 8 të këtij vendimi, përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit të Ekonomisë Kreative, e cila miratohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrisë të Financave.

12. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

13. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për parashikimin e Fondit të Ekonomisë Kreative në buxhetin afatmesëm.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 956, datë 9.5.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 538, DATË 26.5.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET
QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA
NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 pika 1 shkronja “ç”, 15 dhe 36 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 66 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 333, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aneksi 4, që i bashkëlidhë vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me aneksin 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Kërkesat për licenca, leje, autorizime, certifikata dhe për çdo akt tjetër administrativ, që lidhet me veprimtaritë e përcaktuara në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, trajtohen sipas përcaktimeve të aneksit 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. Zbatimi i kësaj procedure bëhet pa ndryshime në strukturën organizative dhe buxhetin e QKL-së.
 4. Subjektet zhvilluese të veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, që kanë bërë kërkesa për licenca, leje, autorizime, certifikime apo akte të tjera administrative konkrete para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, vendosin vetë nëse do të vazhdojnë procedurën e nisur apo do të rinisin procedurën sipas këtij vendimi për një apo disa nga kërkesat.
 5. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) marrin të gjitha masat për nisjen e procesit të licencimit sipas procedurës së përcaktuar në këtë vendim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



ANEKSI 4 PËR LICENCIMIN NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

PJESA E PARË: SQARIME TË PËRGJITHSHME

1. Licencimi i projekteve energjetike përfshin, nëse është rasti, dy etapa procedurale:
 - a. Trajtimin fillestar të kërkesave për zhvillimin e projekteve energjetike që kryhet sipas pjesës së dytë të këtij aneksi.
 - b. Trajtimin e mëpasshëm, që përfshin licenca, leje, autorizime, certifikime dhe çdo akt tjetër administrativ që lidhet me veprimtari në sektorin e energjisë elektrike, që kryhet sipas pjesës së tretë të këtij aneksi.
2. Në të gjitha rastet e projekteve energjetike, QKL i dërgon një kopje elektronike të kërkesave dhe dokumenteve AIDA-s si dhe njofton atë periodikisht dhe sipas nevojës për ecurinë, problemet dhe vonesat e ndeshura në trajtimin e kërkesave.
3. Trajtimi i mëpasshëm nuk përfshin lejet e parashikuara në ligjin për planifikimin e territorit, por çdo akt administrativ që është marrë nga subjekti sipas pjesës së tretë të këtij aneksi dhe që kërkohet për marrjen e këtyre lejeve, konsiderohet i mirëqenë. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) njofton AIDA- n periodikisht dhe sipas nevojës për ecurinë, problemet dhe vonesat e ndeshura në trajtimin e kërkesave për këto lloje lejesh.
4. AIDA, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave të saj ligjore, monitoron ecurinë e procesit licencues, vlerëson çështjet dhe lehtëson koordinimin dhe bashkëveprimin e të gjitha institucioneve.

PJESA E DYTË TRAJTIMI FILLESTAR I KËRKESAVE PËR ZHVILLIM TË PROJEKTEVE ENERGJETIKE

1. Trajtimi fillestar i kërkesave për zhvillimin e projekteve energjetike përfshin veprimet dhe vendimet administrative që kryhen lidhur me:
 - a. Propozimet e pakërkua sipas kuptimit të këtij termi të parashikuar në nenet 2(12) dhe 23 të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Per koncesionet”, i ndryshuar (me kodin IV.2)
 - b. Ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni sipas kuptimit të këtij termi të parashikuar në nenin 34/1 të Ligjit Nr. 9062, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe VKM Nr.1701, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së

autorizimit, për ndërtimin e objekteve të reja të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, (me kodin IV.3).

2. Çdo kërkuar depoziton në QKL kërkesën për trajtimin fillestar.
3. QKL regjistron kërkesën dhe ia përcjell brenda 4 ditëve Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE).
4. METE shqyrton kërkesën dhe shprehet nëse ajo paraqet apo jo interes publik, ose lëshon autorizimin paraprak sipas legjislacionit respektiv në fuqi dhe publikon vendimin në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.
5. Nëse METE nuk shprehet brenda afateve respektive ligjore, kërkesa konsiderohet e miratuar lidhur me çështjet e parashikuara në pikën 4 dhe për pasojë kërkuar fiton të drejtat përkatëse sipas legjislacionit respektiv në fuqi. Fitimi i kësaj të drejte në heshtje publikohet automatikisht në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve nga QKL.
6. Pas shprehjes së interesit publik ose lëshimit të autorizimit paraprak, trajtimi fillestar i kërkesës vazhdon sipas legjislacionit në fuqi dhe pa përfshirjen e QKL-së, deri në lidhjen e kontratës koncesionare ose kontratës lidhur me ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, ndërmjet subjektit dhe METE.
7. Pjesë e akteve përfundimtare të trajtimit fillestar është edhe një aneks që sqaron se cilat nga licencat, lejet, autorizimet apo aktet e tjera administrative, pjesë e licencimit të mëpasshëm, janë miratuar përgjatë trajtimit fillestar.
8. Çdo akt i ndërmjetëm ose përfundimtar i trajtimit fillestar publikohet edhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.
9. Kur për shkaqe të përligjura bëhet i nevojshëm ndryshimi i kushteve të parashikuara në aktin përfundimtar të trajtimit fillestar, ndryshimet kryhen sipas procedurës së legjislacionit përkatës, por kërkesa paraqitet fillimisht në QKL e cila ia kalon për shqyrtim METE-s, që më pas ndjek procesin përkatës ligjor.
10. Trajtimi i mëpasshëm sipas pjesës së tretë të këtij aneksi, kryhet vetëm për ato akte të cilat nuk janë pjesë e aneksit të cituar në pikën 7 më sipër, përjashtuar rastin kur për shkaqe të përligjura sipas legjislacionit përkatës, bëhet e nevojshme një ndryshim i kushteve ose kritereve të përcaktuara në këto akte.



PJESA E TRETË **LICENCIMI I MËPASSHËM I KËRKESAVE PËR PROJEKTE ENERGJETIKE**

KATEGORIA III.1 (ANEKSI 1, I VKM NR. 538) **LEJA MJEDISORE**

1. Leja mjedisore me kodin III.1, me të cilën pajisjen subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën energjetike dhe që procedohet sipas kushteve të Aneksit 1 të VKM Nr. 538, trajton njëkohësisht dhe jep zgjidhje edhe rasteve që lidhen me përdorimin e ujit për vepra energjetike, heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor dhe/ose kullësor ose për përdorimin me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe/ose kullësor, si dhe çdo çështje tjetër që lidhet me përdorimin e burimeve mjedisore bazë, sipas fushës III të Shtojcës të Ligjit Nr. 10081.
2. Kur pronësia mbi burimet mjedisore bazë nuk është e shtetit, leja mjedisore sipas pikës 1 trajton dhe zgjidh çështjet e aspektit mjedisor dhe i hap rrugë qartësimi dhe zgjidhjes të çështjeve pronësore mbi këto burime, të cilat trajtohen më vetë sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kur gjatë trajtimit fillestar janë zgjidhur çështje të caktuara mjedisore, në trajtimin e mëpasshëm zgjidhen vetëm çështjet e mbetura.
4. Leja mjedisore për çështjet që lidhen me përdorimin e ujit, përcakton një afat jo më të shkurtër sesa afati i kontratës koncesionare. Ky përcaktim zbatohet automatikisht për të gjitha projektet energjetike me kontrata koncesionare të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

KATEGORIA XX.1

MIRATIMI I PROJEKTIT PËR DIGAT/DAMBAT

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimi i projektit për digat/dambat përfshihet në kategorinë XX.1.
2. Miratimi i projektit për digat/dambat ndahet në këto nënkategori:
 - a. Miratimi i projektit për digat/dambat për veprat energjetike me kodin XX.1.E.
 - b. Miratimi i projektit për digat/dambat për vepra të tjera me kodin XX.1.T.

II. MIRATIMI I PROJEKTIT TË PËR DIGAT/DAMBAT PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.1.E

Miratimi i projektit për digat/dambat specifikohet në:

- a. Miratimi i projekt-idesë me kodin XX.1.E.1.
- b. Miratimi i projektit të zbatimit me kodin XX.1.E.2.

III. MIRATIMI I PROJEKT-IDESË DHE I PROJEKT-ZBATIMIT

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin e projekt-idesë ose projektit të zbatimit për digat/dambat e lumenjve për veprat energjetike janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, pa miratim në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM).
4. Afati i kthimit të përgjigjes për miratimin e projekt-idesë është 30 ditë, ndërsa afati për miratimin e projektit të zbatimit është 45 ditë.

IV. MIRATIMI I PROJEKTIT PËR DIGAT/DAMBAT PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.1.T

Miratimi i projektit për digat/dambat për vepra të tjera me kodin XX.1.T trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.



KATEGORIA XX. 2 **DEKLARATË KONFORMITETI PËR KRITERET SIZMOLOGJIKE**

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Deklarata e konformitetit për kriteret sizmologjike bën pjesë në kategorinë XX.2.
2. Deklarata e konformitetit për kriteret sizmologjike ndahet në këto nënkategori:
 - a. Deklaratë konformiteti për kriteret sizmologjike për veprat energjetike me kodin XX.2.E.
 - b. Deklaratë konformiteti për kriteret sizmologjike për vepra të tjera me kodin XX.2.T.

II. DEKLARATA E KONFORMITETIT PËR KRITERET SIZMOLOGJIKE PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.2.E

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin e deklaratës së konformitetit për kriteret sizmologjike, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.
4. Afati i marrjes së vendimit është 20 ditë.

III. DEKLARATË KONFORMITETI PËR KRITERET SIZMOLOGJIKE PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.2.T

Deklarata e konformitetit me kriteret sizmologjike për vepra të tjera me kodin XX.2.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

KATEGORIA XX. 3

LEJE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT NË ZONAT ARKEOLOGJIKE OSE TRASHËGIMI KULTURORE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Leja për ushtrimin e aktivitetit në zonat arkeologjike ose trashëgimi kulturore bën pjesë në kategorinë XX.3.
2. Leja për ushtrimin e aktivitetit në zonat arkeologjike ose trashëgimi kulturore ndahet në këto nënkategori:
 - a. Leje për ushtrimin e aktivitetit në zonat arkeologjike ose trashëgimi kulturore, për veprat energjetike me kodin XX.3.E.
 - b. Leje për ushtrimin e aktivitetit në zonat arkeologjike ose trashëgimi kulturore për vepra të tjera me kodin XX.3.T.

II. LEJE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT NË ZONAT ARKEOLOGJIKE OSE TRASHËGIMI KULTURORE PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.3.E

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin e lejes për ushtrimin e aktivitetit në një zonë arkeologjike ose trashëgimi kulturore, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë sipas rastit mosprekjen e zonës apo lejimin me kusht.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
4. Afati i marrjes së vendimit është 40 ditë.

III. LEJE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT NË ZONAT ARKEOLOGJIKE OSE TRASHËGIMI KULTURORE PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.3.T

Leja për ushtrimin e aktivitetit në zonat arkeologjike ose trashëgimi kulturore për vepra të tjera me kodin XX.3.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.



KATEGORIA XX. 4 **AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE UJËSJELLËS/KANALIZIME**

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Autorizimi për prekjen e rrjeteve ujësjellës/kanalizime bën pjesë në kategorinë XX.4
2. Autorizimi për prekjen e rrjeteve ujësjellës/kanalizime ndahet në këto nënkategori:
 - a. Autorizim për prekje të rrjeteve ujësjellës/kanalizime për veprat energjetike me kodin XX.4.E.
 - b. Autorizim për prekje të rrjeteve ujësjellës/kanalizime për vepra të tjera me kodin XX.4.T.

II. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE UJËSJELLËS/KANALIZIME PËR VEPRAT ENERGETIKE ME KODIN XX.4.E

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin e autorizimit për prekjen e rrjeteve ujësjellës/kanalizime, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë sipas rastit mosprekjen e rrjetit apo autorizimin për prekje.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve.
4. Afati i marrjes së vendimit është 40 ditë.

III. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE UJËSJELLËS/KANALIZIME PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.4.T

Autorizimi për prekjen e rrjeteve ujësjellës/kanalizime për vepra të tjera me kodin XX.4.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

KATEGORIA XX. 5

AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE ELEKTRIKE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Autorizimi për prekjen e rrjeteve elektrike bën pjesë në kategorinë XX.5
2. Autorizimi për prekjen e rrjeteve elektrike ndahet në këto nënkategori:
 - a. Autorizim për prekje të rrjeteve elektrike për veprat energjetike me kodin XX.5.E.
 - b. Autorizim për prekje të rrjeteve elektrike për vepra të tjera me kodin XX.5.T.

II. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE ELEKTRIKE PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.5.E

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin e autorizimit për prekjen e rrjeteve elektrike, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë sipas rastit mosprekjen e rrjetit apo autorizimin për prekje.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është OSSH(CEZ Albania)/OST.
4. Afati i marrjes së vendimit është 40 ditë.

III. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE ELEKTRIKE PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.5.T

Autorizimi për prekjen e rrjeteve elektrike për vepra të tjera me kodin XX.5.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.



KATEGORIA XX. 6

AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE TELEFONIKE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Autorizimi për prekjen e rrjeteve telefonike bën pjesë në kategorinë XX.6.
2. Autorizimi për prekjen e rrjeteve telefonike ndahet në këto nënkategori:
 - a. Autorizim për prekje të rrjeteve telefonike për veprat energjetike me kodin XX.6.E.
 - b. Autorizim për prekje të rrjeteve telefonike për vepra të tjera me kodin XX.6.T.

II. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE TELEFONIKE PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.6.E

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin e autorizimit për prekjen e rrjeteve telefonike, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë sipas rastit mosprekjen e rrjetit apo autorizimin për prekje.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është ALBTELECOM.
4. Afati i marrjes së vendimit është 40 ditë.

III. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE TELEFONIKE PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.6.T

Autorizim për prekjen e rrjeteve telefonike për vepra të tjera me kodin XX.6.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

KATEGORIA XX. 7

AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE RRUGORE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Autorizimi për prekjen e rrjeteve rrugore bën pjesë në kategorinë XX.7
2. Autorizimi për prekjen e rrjeteve rrugore ndahet në këto nënkategori:
 - a. Autorizim për prekje të rrjeteve rrugore për veprat energjetike me kodin XX.7.E
 - b. Autorizim për prekje të rrjeteve rrugore për vepra të tjera me kodin XX.7.T

II. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE RRUGORE PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.7.E

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin e autorizimit për prekjen e rrjeteve rrugore, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë sipas rastit mosprekjen e rrjetit apo autorizimin për prekje.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është sipas rastit Autoriteti Kombëtar i Rrugëve, Këshilli i Qarkut, Bashkia/Komuna. Në rastin kur institucioni tjetër nuk është i lidhur në rrjet, QKL dërgon kërkesën me postë.
4. Afati i marrjes së vendimit është 40 ditë.

III. AUTORIZIM PËR PREKJE TË RRJETEVE RRUGORE PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.7.T

Autorizimi për prekjen e rrjeteve rrugore për vepra të tjera me kodin XX.7.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.



KATEGORIA XX.8 DEKLARATË KONFORMITETI NGA PMNZSH

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Deklarata e konformitetit nga PMNZSH përfshihet në kategorinë XX.8
2. Deklarata e konformitetit nga PMNZSH ndahet në këto nënkategori:
 - a. Deklaratë konformiteti nga PMNZSH për veprat energjetike me kodin XX.8.E.
 - b. Deklaratë konformiteti nga PMNZSH për vepra të tjera me kodin XX.8.T.

II. DEKLARATË KONFORMITETI NGA PMNZSH PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.8.E

1. Kriteret e posaçme si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për miratimin deklaratës së konformitetit nga PMNZSH për veprat energjetike, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është Drejtoria e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit.
4. Afati i kthimit të përgjigjes është 20 ditë.

III. DEKLARATË KONFORMITETI NGA PMNZSH PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.8.T

Deklarata e konformitetit nga PMNZSH për vepra të tjera me kodin XX.8.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

**KATEGORIA XX.9
CERTIFIKIMI I PROJEKTEVE ELEKTRIKE**

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Certifikimi i projekteve elektrike përfshihet në kategorinë XX.9.
2. Certifikimi i projekteve elektrike ndahet në këto nënkategori:
 - a. Certifikimi i projekteve elektrike për veprat energjetike me kodin XX.9.E.
 - b. Certifikimi i projekteve elektrike për vepra të tjera me kodin XX.9.T.

II. CERTIFIKIMI I PROJEKTEVE ELEKTRIKE PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.9.E

1. Kriteret e posaçme të certifikimit si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për certifikimin e projekteve për veprat energjetike, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është Inspektorati Qendror Teknik.
4. Afati i kthimit të përgjigjes është 20 ditë.

III. CERTIFIKIMI I PROJEKTEVE ELEKTRIKE PËR VEPRA TË TJERA ME KODIN XX.9.T

Certifikimi i projekteve elektrike për vepra të tjera me kodin XX.9.T trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.



KATEGORIA XX. 10 **AUTORIZIM PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE**

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Autorizimi për përdorim civil të lëndëve plasëse përfshihet në kategorinë XX.10.
2. Autorizimi për përdorim civil të lëndëve plasëse ndahet në këto nënkategori:
 - a. Autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse për veprat energjetike me kodin XX.10.E
 - b. Autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse për vepra të tjera me kodin XX.10.T

II. AUTORIZIM PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.10.E.

1. Kriteret e posaçme dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për autorizimin për përdorim civil të lëndëve plasëse për veprat energjetike, janë ato respektive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, përfshirë miratimin në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që shqyrton plotësimin e kriterëve, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
4. Afati i kthimit të përgjigjes është 20 ditë.

III. AUTORIZIM PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE PËR VEPRAT TË TJERA ME KODIN XX.10.T.

Autorizimi për përdorim civil të lëndëve plasëse për vepra të tjera me kodin XX.10.T trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

KATEGORIA XX. 11
IDENTIFIKIMI I PRONËSISË DHE MARRËVESHJA MBI PASURITË E
PALUAJTSHME

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Identifikimi i pronësisë dhe marrëveshja mbi pasuritë e paluajtshme përfshihet në kategorinë XX.11
2. Identifikimi i pronësisë dhe marrëveshja mbi pasuritë e paluajtshme ndahet në këto nënkategori:
 - a. Identifikimi i pronësisë dhe marrëveshja mbi pasuritë e paluajtshme për veprat energjetike me kodin XX.11.E
 - b. Identifikimi i pronësisë dhe marrëveshja mbi pasuritë e paluajtshme për vepra të tjera me kodin XX.11.T

II. IDENTIFIKIMI I PRONËSISË DHE MARRËVESHJA MBI PASURITË E
PALUAJTSHME PËR VEPRAT ENERGJETIKE ME KODIN XX.11.E

Identifikimi i pronësisë dhe marrëveshja mbi pasuritë e paluajtshme specifikohet në:

- a. Identifikimi i pronarëve të regjistruar të pasurive të paluajtshme me kodin XX.11.E.1.
- b. Identifikimi i organit qendror apo vendor administrues së pasurisë së paluajtshme me kodin XX.11.E.2.
- c. Lidhje e marrëveshjes mbi të drejtat e pronësisë me kodin XX.11.E.3.

II.1. IDENTIFIKIMI I PRONARËVE TË REGJISTRUAR TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME ME KODIN XX.11.E.1

1. Subjekti paraqet në QKL kërkesën së bashku me një listë të pronave me numër regjistrimi pranë ZRPP dhe zonat kadastrale përkatëse.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, pa miratim në heshtje.



3. Institucioni tjetër, që verifikon pronarët e pasurisë së paluajtshme, është ZRPP.
4. Afati i kthimit të përgjigjes është 20 ditë.

II.2. IDENTIFIKIMI I ORGANIT QENDROR APO VENDOR ADMINISTRUES SË PASURISË SË PALUAJTSHME

Në rastet kur nga të dhënat e ZRPP-së, sipas pikës II.1 nuk identifikohet organi që ka të drejtën e administrimit të pronës së paluajtshme, atëherë zbatohet procedura e mëposhtme:

1. Subjekti paraqet kërkesë në QKL për identifikimin e organit qendror apo vendor administrues së pasurisë së paluajtshme.
2. Kërkesa trajtohet si grup III, pa miratim në heshtje.
3. Institucioni tjetër, që verifikon organin qendror/vendor që ka pronësinë/ të drejtën e administrimit të pronës shtetërore, është Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP).
4. Afati i kthimit të përgjigjes është 20 ditë.

II.3. LIDHJA E MARRËVESHJES MBI TË DREJTAT E PRONËSISË ME KODIN XX.11.E.3

1. Bazuar në informacionin e marrë nga ZRPP dhe AITPP, dhe sipas rrethanave të të drejtave konkrete të pronësisë, subjekti i cili do ndërtojë veprën energjetike negocion dhe lidh vetë marrëdhëniet e pronësisë me subjektet, shtetërore a private, që posedojnë të drejtat pronësore.
2. Kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi mundësia e tjetërsimit të të drejtave të pronësisë në favor të shtetit për interes publik subjekti mund të kërkojë nisjen e procedurës për kryerjen e tjetërsimit. Në këtë rast:
 - a. Subjekti paraqet kërkesë në QKL
 - b. Kërkesa trajtohet si grup III, pa miratim në heshtje.
 - c. Institucioni tjetër, që kryen ose inicion procedurat për tjetërsimin e të drejtave pasurore , është METE.
 - d. Kërkesa shqyrtohet nga METE brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi sipas llojit të të drejtave që kërkohen të tjetërsohen dhe statusit shtetëror apo privat të poseduesit.

- e. METE mund të kthejë përgjigje negative, të kërkojë plotësimin e kërkesës apo ta miratojë atë e në këtë rast t'ia përcjellë Këshillit të Ministrave për vendimmarrje përfundimtare tjetërsuese sipas rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
- f. Pas tjetërsimit kërkuesi dhe METE lidhin marrëveshjen mbi të drejtat e pronësisë sipas legjislacionit në fuqi.

III. IDENTIFIKIMI I PRONËSISË DHE MARRËVESHJA MBI PASURITË E PALUAJTSHME PËR VEPRAT TË TJERA, ME KODIN. XX.11.T

Identifikimi i pronësisë dhe marrëveshja e pronësisë mbi tokën për veprat të tjera me kodin. XX.11.T, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

VENDIM

Nr. 957, datë 19.12.2012

PËR MBETJET NGA PAJISJET ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, përmes minimizimit të ndikimeve negative nga mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

2. Vendimi synon:

- a) të parandalojë mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- b) të nxitë ripërdorimin, riciklimin dhe forma të tjera rikuperimi të mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike, me qëllim që të pakësojë asgjësimin e tyre;
- c) të përmirësojë performancën mjedisore të të gjithë operatorëve, si: të prodhuesve, të shpërndarësve dhe konsumatorëve të përfshirë në ciklin e jetës së pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe, në veçanti, të operatorëve që janë të përfshirë drejtpërdrejt në trajtimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

¹ Projektvendimi transponon direktivën 2002/96/EC të Parlamentit dhe Këshillit Europian, e datës 27 janar 2003 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)” CELEX nr. 32006L0066; e amenduar nga direktiva 2003/108/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 8 dhjetor 2003.

(CELEX nr. 32003L0108);

Direktiva është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në datën 26.9.2003.



KREU II FUSHA E ZBATIMIT

1. Ky vendim zbatohet për të gjitha pajisjet elektrike dhe elektronike, që në mënyrë të përgjithshme jepen në aneksin IA, bashkëlidhur këtij vendimi, kurse në mënyrë të hollësishme jepen në aneksin IB, me kusht që pajisja përkatëse të mos jetë pjesë e një lloji tjetër pajisjeje, që nuk përfshihet në fushën e zbatimit të këtij vendimi.

2. Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij vendimi pajisjet që lidhen me mbrojtjen e interesave kryesore të sigurisë së shtetit, armët, municionet dhe materialet e luftës. Ky përjashtim nuk zbatohet për produktet që nuk janë projektuar posaçërisht për qëllime ushtarake.

KREU III PËRKUFIZIMET

Për qëllime të këtij vendimi të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, kanë të njëjtin kuptim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjenci”, autoriteti publik, siç përcaktohet në kreun X seksioni 1 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

2. “Mbetje historike”, MPEE-të nga produktet e hedhura në treg përpara datës 1 janar 2015.

3. “Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” ose “MPEE”, një pajisje elektrike ose elektronike, që është mbetje sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe përfshin të gjitha pjesët e përbërësit e tyre, pjesët lidhëse e përdoruese, si dhe pjesët e konsumit që janë pjesë përbërëse e produktit në kohën kur hidhet.

4. “MPEE nga përdoruesit joshtëpiakë”, MPEE-të që vijnë nga burimet tregtare, industriale, institucionale dhe të tjera, që, për shkak të natyrës dhe sasisë së tyre, janë të ndryshme me ato që vijnë nga përdoruesit shtëpiakë.

5. “Ministria”, ministria përgjegjëse për mjedisin.

6. “Ministri”, ministri përgjegjës për mjedisin.

7. “MPEE shtëpiake”, mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike, që vijnë nga sektori privat familjar dhe nga burimet tregtare, industriale, të institucioneve dhe të tjera, që, për shkak të natyrës e të sasisë së tyre, janë të ngjashme me mbetjet shtëpiake.

8. “Njësi e qeverisjes vendore”, komuna, bashkia, qarku dhe nënndarjet e tyre, në përputhje me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

9. “Pajisje elektrike dhe elektronike” ose “PEE” nënkupton:

a) pajisjet, funksionimi i rregullt i të cilave varet nga rrymat elektrike ose fushat elektromagnetike;

b) pajisjet për gjenerimin, transferimin dhe matjen e këtyre rrymave dhe fushave që përcaktohen në kategoritë e aneksit IA dhe janë të projektuara për t’u përdorur me një tension, që nuk i tejkalon 1000 V (volt) për rrymë alternative dhe 1500 V (volt) për rrymë të drejtpërdrejtë.

10. “Preparet” ka kuptimin e dhënë sipas ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”.

11. “Prodhues”, çdo person që, pavarësisht nga teknika e përdorur e shitjes, përfshirë mjetet e komunikimit në distancë:

a) prodhon dhe shet pajisje elektrike dhe elektronike mbi të cilat ka shënuar markën e vet;

b) rishet në emër të markës së vet pajisje të prodhuara nga furnitorë të tjerë, por jo në rastin kur në pajisje është shënuar marka e prodhuesit, siç parashikohet në shkronjën “a” më lart;

c) importon ose eksporton PEE mbi baza profesionale në një shtet tjetër.

12. “Substancë” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”.

13. “Sistem individual për kthimin mbrapsht të MPEE-ve”, sistemi, ku një subjekt prodhues apo tregtues merr përsipër individualisht të gjithë përgjegjësinë e menaxhimit të mbetjeve.

14. “Sistem kolektiv për kthimin mbrapsht të MPEE-ve”, sistemi ku një ose më shumë subjekte prodhuese apo tregtuese marrin përsipër bashkërisht përgjegjësinë e menaxhimit të mbetjeve.

15. Substancë ose preparat i rrezikshëm”, çdo substancë ose preparat që është shpërthyes, oksidues, shumë i djegshëm apo i djegshëm, toksik, dëmtues, gërryes apo irritues, sipas përkufizimeve që u bëhen këtyre vetive në aneksin III të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

16. “Shpërndarës”, çdo person që ofron PEE për qëllime tregtie për palën që do ta përdorë atë.

KREU IV REGJISTRIMI I PRODHUESVE

1. Prodhuesit e PEE-ve përpara se të hedhin në treg për herë të parë mbi baza profesionale produktet e tyre, pajisen me leje mjedisi të fushës III, në përputhje me përcaktimin e bërë në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, regjistrohen në regjistrin e prodhuesve të PEE-ve, që agjencia krijon për këtë qëllim dhe pajisen me një numër regjistrimi.

2. Regjistrimi i çdo prodhuesi bëhet vetëm një herë në momentin kur hedh në treg PEE për herë të parë mbi baza profesionale.

3. Gjatë regjistrimit në agjenci për qëllime të këtij vendimi përfshihen vetëm të dhënat e mëposhtme:

- a) Emri i prodhuesit dhe i markës (nëse ka) me të cilin operon në Republikën e Shqipërisë;
- b) Adresa/t e plotë/a e/të prodhuesit: kodi postal dhe vendndodhja, emri i rrugës dhe numri, faqja e internetit, adresa e e-mail-it, kutia postare, numri i telefonit dhe faksit, personi i kontaktit;
- c) Të dhëna për kategoritë e PEE-ve të hedhura në treg nga prodhuesi;
- ç) Informacion për mënyrën se si prodhuesi përmbush detyrimet e tij, nëpërmjet një skeme individuale apo nëpërmjet një skeme kolektive;
- d) Data e aplikimit për regjistrim;
- dh) Kodi kombëtar i identifikimit të prodhuesit, përfshirë numrin e NIPT-it në Republikën e Shqipërisë apo në nivel evropian;
- e) Deklarata që pohon se informacioni i dhënë është i vërtetë.

4. Prodhuesit e PEE-ve:

a) njoftojnë agjencinë për çdo ndryshim që mund të pësojë informacioni i dhënë sipas pikës 3, jo më vonë se 1 (një) muaj pas bërjes së ndryshimit;

b) kërkojnë me shkrim nga agjencia çregjistrimin nga regjistri i PEE-ve, kur pushojnë aktivitetin e tyre të prodhimit të PEE-ve dhe nuk ushtrojnë më këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

5. Agjencia bën çregjistrimin nga regjistri i prodhuesve të PEE-ve dhe njofton me shkrim për kryerjen e çregjistrimit.



KREU V PROJEKTIMI I PRODUKTIT

1. Ministria dhe ministria përgjegjëse për ekonominë nxitin projektimin e prodhimit të PEE-ve në zbatim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të cilat lehtësojnë çmontimin dhe rikuperimin, në veçanti, ripërdorimin e riciklimin e MPEE-ve, të përbërësve dhe të materialeve të tyre.

2. Prodhuesit projektojnë PEE-të në mënyrë të tillë që tiparet e tyre apo proceset prodhuese të mos pengojnë ripërdorimin, përveçse kur këto tipare specifike apo procese prodhuese paraqesin përparësi të mëdha në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe/ose sigurinë.

KREU VI ETIKETIMI I PRODUKTIT

1. Prodhuesit që hedhin në treg PEE, me qëllim që të minimizojnë hedhjen e MPEE-ve në të njëjtin vend me mbetjet shtëpiake të përziera, për të lehtësuar grumbullimin e tyre të diferencuar, i etiketojnë ato me simbolin që tregohet në aneksin IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në rastin kur përmasat dhe funksionet e PEE-ve nuk mundësojnë etiketimin e tyre, etiketimi kryhet në gjuhën shqipe:

- a) duke bashkëngjitur një etiketë ose tabelë shtesë me simbolin e përcaktuar në pikën 1;
- b) duke printuar simbolin e përcaktuar në pikën 1, në të njëjtën kohë, mbi paketimin, udhëzuesin e shërbimit dhe në fletën e garancisë.

3. Etiketa e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij kreu, nuk duhet të zhubroset, paloset, përthyeret ose të rrudhoset dhe duhet të jetë e dukshme, e lexueshme dhe të mos shqitet.

4. Prodhuesi i PEE-ve në territorin e Republikës së Shqipërisë përjashtohet nga detyrimi për ta etiketuar PEE-në sërish, nëse PEE-të e importuara nga një shtet tjetër anëtar i BE-së janë etiketuar në përputhje me kërkesat e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij kreu.

5. Prodhuesit i etiketojnë PEE-të e hedhura në treg pas datës 1 janar 2015 dhe i identifikojnë duke vendosur një etiketë të dukshme, të lexueshme e të fortë mbi pajisje, e cila përmban emrin e personit, fizik ose juridik dhe numrin identifikues.

KREU VII GRUMBULLIMI I DIFERENCUAR

1. Njësitë e qeverisjes vendore, prodhuesit dhe shpërndarësit apo palë të treta që veprojnë në emër të tyre marrin masat e nevojshme për të minimizuar asgjësimin e MPEE-ve si mbetje e pandarë nga mbetjet e tjera bashkiake dhe për të siguruar një nivel të lartë grumbullimi të diferencuar të MPEE-ve.

2. Për MPEE-të që vijnë nga përdoruesit shtëpiake, brenda 3 (tri) viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi:

a) prodhuesit, nisur nga dendësia e popullsisë, marrin masat e nevojshme dhe vënë në funksionim një numër të mjaftueshëm vendesh grumbullimi që janë lehtësisht të aksesueshme dhe që lejojnë zotëruesit përfundimtarë e shpërndarësit të kthejnë mbrapsht këto mbetje;

b) prodhuesit/shpërndarësit, kur ofrojnë/shesin një produkt të ri, marrin masat e duhura për të siguruar që mbetjet e këtij produkti të mund t'i kthehen të paktën në raportin një me një, me kusht që pajisja të jetë e të njëjtit lloj dhe të ketë kryer të njëjtat funksione si pajisja e ofruar/e shitur;

c) pavarësisht nga parashikimet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2, prodhuesit, sipas rastit, mund të krijojnë dhe të vënë në funksionim sisteme individuale dhe/ose kolektive për kthimin

mbrapsht të MPEE-ve nga përdoruesit shtëpiakë, me kusht që këto sisteme të jenë në përputhje me objektivat e qëllimit të këtij vendimi;

ç) prodhuesit mund të refuzojnë të marrin mbrapsht MPEE-të, që:

i) për shkak të ndotjes përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e personelit;

ii) u mungojnë pjesë kryesore;

iii) përmbajnë mbetje të ndryshme nga ato të MPEE-ve.

d) MPEE-të që refuzohen të merren mbrapsht u nënshtrohen rregullave të menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme sipas ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

3. Për MPEE-të, që vijnë nga përdoruesit joshtëpiakë, prodhuesit apo palë të treta, që veprojnë në emër të tyre e kryejnë vetë grumbullimin.

4. Grumbullimi, transportimi dhe magazinimi i MPEE-ve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij kreu, kryhen nga subjekte të pajisura me licencën e nënkategorisë III.2.B “Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, dhe në mënyrë të tillë, që të maksimizohet së pari ripërdorimi i pajisjeve të plota ose i pjesëve të tyre dhe, më pas, riciklimi i pjesëve dhe përbërësve të tyre.

5. Me përjashtim të MPEE-ve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij kreu, dhe që ripërdoren në trajtën e tyre të plotë, pjesa tjetër e MPEE-ve të grumbulluara transportohen në vende/impianete trajtimi të pajisura me licencën e nënkategorisë III.2.B “Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”.

6. Kuota minimale e detyrueshme e grumbullimit të diferencuar të MPEE-ve në nivel kombëtar është mesatarisht 4 kg/për banor/vit për MPEE-të e përdoruesve shtëpiakë.

7. Njësitë e qeverisjes vendore përcaktojnë e miratojnë vendet e grumbullimit të diferencuar të MPEE-ve.

KREU VIII TRAJTIMI, RICIKLIMI DHE RIKUPERIMI

1. Prodhuesit ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre ngrenë sisteme të posaçme për trajtimin, riciklimin dhe rikuperimin e MPEE-ve, duke përdorur teknikat më të mira të disponueshme për trajtimin, riciklimin dhe rikuperimin.

2. Prodhuesit krijojnë sisteme individuale ose kolektive për trajtimin, riciklimin dhe rikuperimin e MPEE-ve.

3. Trajtimi i MPEE-ve kryhet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Sa i takon trajtimin të MPEE-ve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, eksporti i MPEE-ve kryhet sipas legjislacionit në fuqi për eksportin e mbetjeve.

4. Prodhuesit ose palët e treta, që kryejnë veprimtarinë e trajtimit, riciklimit dhe rikuperimit, pajisen me leje mjedisi të kategorisë III.1 dhe licencë të nënkategorisë III.2.B të fushës III, sipas përcaktimit të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

5. Prodhuesit ose palët e treta që merren me trajtimin:

a) bëjnë minimalisht heqjen e të gjitha lëngjeve që përmbahen në MPEE dhe një trajtim të përzgjedhur sipas aneksit II, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) magazinojnë dhe përpunojnë MPEE-të në përputhje me kërkesat teknike të parashikuara në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Akti i miratimit për lejen e mjedisit të kategorisë III.1 dhe licencën e nënkategorisë III.2.B të fushës III, sipas përcaktimit të bërë në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, përfshin të gjitha kushtet e nevojshme që plotësojnë kërkesat e



pikave 2, 3 dhe 5 të këtij kreu, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar në kreun VII të këtij vendimi.

7. Ministria dhe ministria përgjegjëse për ekonominë nxitin prodhuesit ose palët e treta të përfshihen në skemat e ekomenaxhimit dhe ekoauditimit (EMAS).

8. Ministria dhe ministria përgjegjëse për ekonominë nxitin zhvillimin e teknologjive të reja të trajtimit, riciklimit dhe rikuperimit.

KREU IX

MONITORIMI I REZULTATEVE DHE RAPORTIMI

1. Objektivat minimalë të detyrueshëm për MPEE-të e grumbulluara në mënyrë të diferencuar dhe të trajtuara sipas kërkesave të kreut VIII nga çdo prodhues, deri më 1 janar të vitit 2015 janë, si më poshtë vijon:

- a) Për MPEE-të e kategorive 1 dhe 10 të aneksit IA:
 - i) përqindja e rikuperimit të jetë 80% e peshës mesatare të pajisjes;
 - ii) përqindja e ripërdorimit dhe riciklimit të pjesëve përbërëse, materialeve dhe substancave të jetë 75% e peshës mesatare të pajisjes;
- b) Për MPEE-të e kategorive 3 dhe 4 të aneksit IA:
 - i) përqindja e rikuperimit të jetë 75% e peshës mesatare të pajisjes;
 - ii) përqindja e ripërdorimit dhe riciklimit të pjesëve përbërëse, materialeve dhe substancave të jetë 65% e peshës mesatare të pajisjes.
- c) Për MPEE-të e kategorive 2, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të aneksit IA:
 - i) përqindja e rikuperimit të jetë 70% e peshës mesatare të pajisjes;
 - ii) përqindja e ripërdorimit dhe riciklimit të pjesëve përbërëse, materialeve dhe substancave të jetë 50% e peshës mesatare të pajisjes;
- ç) Për llambat me përmbajtje gazi, përqindja e ripërdorimit dhe riciklimit të pjesëve përbërëse, materialeve dhe substancave të jetë 80% e peshës së llambës.

2. Prodhuesit ose palët e treta, që veprojnë në emër të tyre, matin dhe regjistrojnë në regjistrat e tyre të krijuar për këtë qëllim peshën e çdo PEE-je, MPEE-je, të pjesëve përbërëse, materialeve ose substancave të tyre kur futen dhe kur dalin nga vendet/impianetet e trajtimit, rikuperimit dhe/ose riciklimit dhe llogaritin përqindjet përkatëse sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1, të realizuara prej tyre.

3. Pajisjet e plota të përmendura në pikën 4 të kreut VII, nuk merren në konsideratë kur llogariten përqindjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu.

4. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu, brenda datës 31 janar të çdo viti, raportojnë në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore për peshën totale të hyrjeve dhe daljeve të përcaktuara në pikën 2 dhe për përqindjet përkatëse të realizuara prej tyre sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1, për vitin paraardhës.

5. Njësitë e qeverisjes vendore llogaritin peshën totale të hyrjeve dhe daljeve në territorin nën juridiksionin e tyre dhe përqindjet përkatëse sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1, gjatë vitit kalendarik paraardhës dhe i regjistrojnë ato në regjistrat e tyre të krijuar për këtë qëllim.

6. Njësitë e qeverisjes vendore raportojnë brenda muajit prill të çdo viti në agjenci për rezultatet e llogaritjeve të bëra për vitin paraardhës sipas pikës 8 të këtij kreu.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton brenda muajit mars të çdo viti në agjenci për importet dhe eksportet e PEE-ve dhe eksportet e MPEE-ve për vitin paraardhës sipas legjislacionit në fuqi dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për mjedisin për përcaktimin e kodeve tarifore për aneksin IB, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Agjencia llogarit peshën totale të hyrjeve dhe daljeve të përcaktuara në pikën 2 dhe përqindjet e realizuara sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe i regjistron ato në regjistrat e krijuar për këtë qëllim.

9. Agjencia mban të dhënat vjetore për çdo prodhues, për sasitë dhe kategoritë e PEE-ve të hedhura në treg prej tyre, të grumbulluara sipas mënyrave të ndryshme, të ripërdorura, të ricikluara e të rikuperuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për mbetjet e grumbulluara që janë eksportuar.

10. Prodhuesit ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kur matja e PEE-ve dhe MPEE-ve në peshë nuk është e mundur, raportojnë në bazë të numrit të tyre.

KREU X KOSTOT E MENAXHIMIT TË MPEE-ve

1. Kostot e menaxhimit për MPEE-të nga përdoruesit shtëpiakë janë, si më poshtë vijon:

a) Prodhuesit, deri në fund të muajit gusht 2015 financojnë të paktën grumbullimin e diferencuar, trajtimin, rikuperimin dhe asgjësimin e sigurt nga pikëpamja e mjedisit të MPEE-ve shtëpiake, të grumbulluara në vendet e grumbullimit, të krijuara sipas kërkesave të pikës 2 të kreut VII të këtij vendimi.

b) Për produktet që hidhen në treg pas muajit gusht 2015, prodhuesi financon operacionet e përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, për mbetjet e produkteve të veta. Prodhuesi e përmbush këtë detyrim individualisht ose duke iu bashkuar një skeme kolektive.

c) Sa herë që hedh në treg një produkt të ri, prodhuesi vendos një garanci që siguron dhe garanton se do të financojë menaxhimin e MPEE-ve të tij. Garancia do të vendoset dhe do të garantohet në një nga format e njohura ligjore nga një institucion financiar i licencuar sipas legjislacionit në fuqi ose si një llogari bankare e ngrirë.

ç) Kur shet produkte të reja, prodhuesi nuk u tregon blerësve kostot e menaxhimit të MPEE-ve të ndara në mënyrë të veçantë.

d) Prodhuesit, në përpjesëtim me kuotën përkatëse, që kanë aktualisht në treg për çdo lloj pajisjeje, përmes një ose disa sistemeve që krijohen për këtë qëllim, financojnë edhe menaxhimin e MPEE-ve historike të produkteve të ngjashme, që janë hedhur në treg përpara datës së përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, por që trajtohen aktualisht.

2. Kostot e menaxhimit për MPEE-të nga përdoruesit joshtëpiakë janë si më poshtë vijon:

a) Për produktet që hidhen në treg, duke filluar pas fundit të muajit gusht 2015, prodhuesit financojnë minimalisht kostot e grumbullimit, trajtimit, rikuperimit dhe asgjësimit të sigurt, që vijnë nga MPEE-të nga përdoruesit joshtëpiakë.

b) Për MPEE-të nga produktet e hedhura në treg përpara muajit gusht 2015 (mbetje historike), financimi i kostove të menaxhimit do të jetë:

i) Prodhuesit që hedhin në treg produkte PEE, që zëvendësojnë produktet e hedhura në treg përpara muajit gusht 2015 me produkte të reja ekuivalente apo që përmbushin të njëjtat funksione, financojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve historike, individualisht, së bashku me përdoruesit joshtëpiakë të tyre ose u kërkojnë këtyre të fundit pagimin e plotë të kostove të menaxhimit.

ii) Përdoruesit joshtëpiakë financojnë kostot e mbetjeve të tjera historike, që nuk përcaktohen në shkronjën “i”.

c) Prodhuesit dhe përdoruesit, pavarësisht nga kërkesat e këtij vendimi, negociojnë sipas rastit marrëveshje që përcaktojnë edhe metoda të tjera financimi.



KREU XI INFORMIMI I PËRDORUESVE

1. Prodhuesit e PEE-ve për përdorime shtëpiake informojnë përdoruesit në lidhje me:
 - a) kërkesat për të mos hedhur MPEE si mbetje shtëpiake të pandara dhe që këto MPEE të grumbullohen në mënyrë të diferencuar;
 - b) sistemet e kthimit dhe të grumbullimit që janë në dispozicion të tyre;
 - c) rolin dhe kontributin e tyre në ripërdorimin, riciklimin dhe forma të tjera rikuperimi të MPEE-ve;
 - ç) efektet potenciale në mjedis dhe në shëndet, si rezultat i prezencës së substancave të rrezikshme që gjenden në PEE;
 - d) kuptimin e simbolit siç tregohet në aneksin IV, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Prodhuesit, për produktet e hedhura në treg pas muajit gusht 2015, me qëllim që të minimizojnë asgjësimin e MPEE-ve si mbetje bashkiake e pandarë dhe për të lehtësuar grumbullimin e tyre të diferencuar, vendosin mbi PEE simbolin e treguar në aneksin IV, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Prodhuesit, në mënyrë përjashtimore, e vendosin simbolin e treguar në aneksin IV mbi ambalazhin e produktit, në instruksionin e përdorimit dhe mbi garancinë e PEE-së, kur një gjë e tillë është e kushtëzuar nga përmasat ose funksioni i produktit.
4. Prodhuesit e japin këtë informacion në formë audioje, vizuale, elektronike, me shkrim, në pikat e shitjes, në instruksionin e përdorimit ose në ndonjë mënyrë tjetër.
5. Prodhuesit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, marrin masat e nevojshme që konsumatorët të marrin pjesë në grumbullimin e diferencuar të MPEE-ve dhe i nxitin ata të lehtësojnë procesin e ripërdorimit, trajtimit dhe rikuperimit.

KREU XII INFORMACION PËR VENDET E TRAJTIMIT

1. Prodhuesit, me qëllim që të lehtësojnë ripërdorimin dhe trajtimin e saktë dhe të padëmshëm të MPEE-ve nga pikëpamja e mjedisit, përfshirë mirëmbajtjen, përmirësimin, rinovimin/ristrukturimin dhe riciklimin dhe për të plotësuar kërkesat e këtij vendimi, një vit pasi çdo pajisje e re është hedhur në treg, ofrojnë për personat përgjegjës për vendet e magazinimit të përkohshëm dhe vendet e menaxhimit të mbetjeve informacion për mundësitë e ripërdorimit e të trajtimit të tyre.
2. Në informacionin sipas pikës 1 identifikohen përbërësit dhe materialet e ndryshme të PEE-ve, si dhe vendndodhja e substancave dhe preparateve të PEE-ve.
3. Informacioni ofrohet në formën e manualeve ose nëpërmjet medias elektronike (p.sh. CD-ROM, shërbime përmes internetit etj.).
4. Prodhuesi i PEE-ve të hedhura në treg pas muajit gusht 2015 vendos mbi pajisje markën e vet për t'u identifikuar, si dhe një shënim që tregon se pajisja është hedhur në treg pas asaj date.

KREU XIII ORGANET PËRGJEGJËSE

1. Ngarkohen ministria, ministria përgjegjëse për ekonominë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njësitë e qeverisjes vendore dhe të gjithë personat, fizikë ose juridikë, të përmendur më lart, për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohet struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, që për detyrimin e vendosjes në treg të pajisjeve elektrike dhe elektronike, sipas kërkesave të këtij vendimi, të marrë masat e duhura sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2001 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Aneksi IA

Kategoritë e pajisjeve elektrike dhe elektronike mbi të cilat zbatohet ky
Vendim:

1. Pajisje të mëdha elektro-shtëpiake
2. Pajisje të vogla elektro-shtëpiake
3. Pajisje IT (të teknologjisë së informacionit) dhe të telekomunikacionit
4. Pajisje konsumi
5. Pajisje ndriçimi
6. Vegla elektrike dhe elektronike (me përjashtim të mjeteve/makinave të pa-
levizëshme industriale me përmasa të mëdha)
7. Lodrat, pajisje për kohën e lirë dhe sportet
8. Aparatura mjekësore (me përjashtim të të gjitha produkteve të transplantuara
dhe të infektuara)
9. Instrumentet e monitorimit dhe kontrollit
10. Makinat automatike me monedhë



ANEKSI I B

Lista e produkteve që do të merren në konsideratë për qëllimin e këtij Vendimi dhe që përfshihen në kategoritë e Aneksit IA

1. Pajisje të mëdha elektro shtëpiake

Pajisje të mëdha ftohjeje

Frigoriferë

Ngrirës

Pajisje të tjera të mëdha të përdorura për ftohje, konservim dhe ruajtje ushqimi

Larëse rrobash

Tharëset e rrobave

Larëse pjatash

Pajisje gatimi

Furra elektrike

Vatra elektrike

Mikrovalë

Pajisje të tjera të mëdha të përdorura për të gatuar dhe për përpunime të tjera të ushqimit

Pajisje elektrike ngrohjeje

Radiatorë elektrikë

Pajisje të tjera të mëdha për ngrohje për dhomat, shretërit, mobiljet e ndenjes

Ventilatorë/ freskues elektrik

Pajisjet e ajrit të kondicionuar

Pajisje të tjera ventilimi, pajisje aspirimi dhe kondicionimi

2. Pajisje të vogla elektro shtëpiake

Fshesat me korrent

Fshirëse tapetesh

Pajisje të tjera pastrimi

Pajisje të përdorura për qepje, thurje, endje dhe procese të tjera për tekstilet

Hekurat dhe pajisje të tjera për hekurosje, makina shtrydhëse dhe për kujdesje të tjera për rrobat

Tostera

Friteza

Grirës, mprehje, makina kafeje dhe pajisje që përdoren për hapjen ose vulosjen e kutive metalike ose pakove

Thikat elektrike

Pajisje për prerjen e flokëve, tharjen e flokëve, larjen e dhëmbëve, pajisje rroje, pajisje masazhi dhe pajisje të tjera për kujdesen e trupit

Sahate, ora dhe pajisje për matjen, tregimin ose regjistrimin e kohës

Peshore

3. Pajisje IT dhe telekomunikacioni

Përpunimi i centralizuar i të dhënave:

Mainframes (kompjuter te mëdhenj të përdorur për shërbime të specializuara)

Minikompjuterat

Njësi printimi

Informatika personale:

Kompjuterët personalë (përfshirë CPU/Njësitë Qendrore të Përpunimit, mausin, ekranin dhe tastierën)

Laptop (përfshirë CPU/Njësitë Qendrore të Përpunimit, mausin, ekranin dhe tastierën)

Kompjuterat Notebook (të vegjël për shënime)

Kompjuterat notepad

Printerat

Fotokopje

Makina shkrimi elektrike dhe elektronike

Makina llogaritëse xhepi ose tavoline

dhe produkte e pajisje të tjera për grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, prezantimin ose komunikimin e informacionit me mjete elektronike.

Terminalet dhe sistemet e përdoruesit

Faks

Teleks

Telefona

Telefona me kartë

Telefona pa kabllo

Celularë

Sisteme përgjigje (me sekretari telefonike)

Dhe produkte apo pajisje të tjera që transmetojnë tinguj, imazhe apo informacione të tjera përmes telekomunikimit

4. Pajisjet e konsumatorit

Aparatet e radiove

Aparatet e televizorëve

Video-kamerat

Video-regjistruesit

Regjistruesit Hi-fi

Audio amplifikatorë

Instrumente muzikore

Dhe produkte ose pajisje të tjera për regjistrim apo riprodhim të tingujve ose imazheve, përfshirë sinjalet ose teknologjitë e tjera për shpërndarjen e zërit dhe imazheve, përveç atyre të telekomunikimit.



5. Pajisjet e ndriçimit

Paisje ndriçimi për llampat fluoreshente me përjashtim të atyre të përdorur në banesa

Llampa fluoreshente lineare

Llampa fluoreshente kompakte

Llampa me intensitet të lartë ndriçimi, përfshirë llampa natriumi me presion dhe llampat me metal halide

Llampa natriumi me presion të ulët

Ndriçues të tjerë ose pajisje për shpërndarjen ose kontrollin e dritave me përjashtim të llampave me filament.

6. Mjete elektrike dhe elektronike (me përjashtim të mjeteve/makinave të palëvizshme industriale me përmasa shumë të mëdha)

Turjelat

Sharrat

Makinat qepëse

Pajisje për tornim, bluarje, lëmim, grirje, sharrim, prerje/krasitje, shpim, hapje gropash, vrimash, palosje, përkulje ose procese të ngjashme për drurin, metalin dhe materiale të tjera.

Mjete për vendosje tercinash, ngulje gozhdash, vidhosje apo heqje të tercinave, të gozhdëve, vidhave ose përdorime të ngjashme.

Mjete për saldim, ngjitje ose përdorim të ngjashëm.

Pajisje për spërkatje, shpërndarje, dispersion ose trajtime të tjera të lëngjeve ose substancave të gazta me mjete të tjera.

Mjete për kositje ose shërbime të tjera kopshtarie.

7. Lodra, pajisje për kohën e lirë, sportive

Trena elektrikë ose komplete me makina garash

Paisje manuale tele-komandimi për video-game

Video-game (lojëra me video)

Kompjuter për çiklizëm, zhytje, vrap, kanotazh, etj.

Pajisje sporti me pjesë elektrike dhe elektronike

Makineri lojërash fati me monedha

8. Paisje mjekësore (me përjashtim të produkteve të transplantuara dhe të infektuara)

Pajisje radioterapie

Kardiologjie

Dialize

Ventilatorë pulmonarë

Mjekësia bërthamore

Pajisje laboratorike për diagnozat in-vitro

Pajisje për kryerje analizash

Ngrirëse

Testet e lindshmërisë

Pajisje të tjera për zbulimin, parandalimin, monitorimin, trajtimin, kurimin e sëmundjeve, plagëve ose paaftësive.

9. Instrumentet e monitorimit dhe kontrollit

Detektor tymi

Rregullator nxehtësie

Termostate

Pajisje matjeje, peshimi ose rregullimi/përshtatje për pajisjet elektro-shtëpiake ose laboratorike

Instrumente të tjera monitorimi dhe kontrolli, të përdorura në instalimet industriale (p.sh. në panelet e kontrollit)

10. Makinat automatike me monedha

Makina automatike për pije të nxehta

Makina automatike për pije të nxehta / të ftohta, me shishe apo kanoçe

Makina automatike për produkte të ngurta

Makina automatike për pará

Të gjitha pajisjet që shpërndajnë automatikisht të gjitha llojet e produkteve.



ANEKSI II

Trajtim i përzgjedhur për materialet dhe pjesët e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike sipas Nenit 6(1) të Direktivës 2002/96/EC

1. Nga të gjitha MPEE të grumbulluar veçmas duhet të hiqen të paktën substancat, preparatet dhe përbërësit e mëposhtëm:

- bifenolet e poliklorinuara (PCB) që përmbajnë kondensatorë
- përbërësit me përmbajtje merkuri si celsa dritash, llampa ndryshuese ose ndriçuese,
- bateritë,
- pllakat me qarqe të printuara të celularëve dhe pajisjeve të tjera, nëse sipërfaqja e pllakës me qark të printuar është më e madhe se 10 cm²,
- kartrixhet/rezervat e bojës, të lëngshme dhe të brumta, dhe me ngjyra,
- Plastikë që përmbajnë flakë-mbrojtës të brominuar,
- mbetjet e asbestit dhe përbërësit që përmbajnë asbest,
- gypat me rreze katodike,
- klorofluorokarbure (CFC), hidroklorofluorokarbure (HCFC) apo hidrofluorokarbure (HFC), hidrokarbure (HC),
- llambat me gaz,
- ekranet me kristale të lëngshme (së bashku me kasën e tyre, kur është e përshtatshme) me një sipërfaqe më të madhe se 100 cm² dhe të gjitha llambat e prapme që punojnë me gaz,
- kabllot e jashtme elektrike,
- elementet që përmbajnë fibra qeramike refraktare,
- elementët që përmbajnë substanca radioaktive, me përjashtim të përbërësve që janë nën kufirin përjashtues të sigurisë në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe publikut nga rreziqet e rrezatimit jonizues,
- kondensatorët elektrolitikë që përmbajnë substanca problematike (lartësia > 25 mm, diametri > 25 mm ose me volum të ngjashëm proporcionalisht).
-

Këto substanca, preparate dhe përbërës asgjësohen ose rikuperohen sipas rregullave të përcaktuar në Ligjin nr..., dt..."Për menaxhimin e mbetjeve".

2. Përbërësit e mëposhtëm të MPEE që grumbullohen veçmas trajtohen si vijon:

- gypave me rreze katodike ju hiqet veshja fluoreshente,
- pajisjeve që përmbajnë gazra ozon-holluese ose kanë potencial për të ndikuar mbi ngrohjen globale (GEP) mbi 15, si psh ato që gjenden në shkumat dhe qarqet ftohëse: gazet nxirren dhe trajtohen sic duhet. Gazrat ozon-holluese trajtohen në përputhje me legjislacionin përkatës për substancat që varfërojnë shtresën e ozonit.
- llampave që lëshojnë gaz ju hiqet merkuri.

3. Duke marrë parasysh konsideratat mjedisore dhe faktin që ripërdorimi dhe riciklimi janë të dëshirueshëm, paragrafët 1 dhe 2 zbatohen në mënyrë të tillë që të mos pengohet ripërdorimi dhe riciklimi i përbërësve ose pajisjes në tërësi në atë mënyrë që nuk dëmton mjedisin.

ANEKSI III


Kërkesat teknike për trajtimin e mbetjeve:

1. Vendet ku magazinohen (përfshirë magazinimin e përkohshëm) MPEE përpara se ato të trajtohen duhet të kenë :
 - aty ku është e nevojshme, sipërfaqe/dysheme të papërshkueshme që shoqërohen edhe me paisje për kapjen dhe grumbullimin e shkarkimeve/pikimeve aksidentale dhe sipas rastit edhe me paisje dekantuese, pastruese - sgrasatuese,
 - aty ku është e nevojshme, mbulesa/tavane për tu mbrojtur nga kushtet e motit.
2. Vendet ku trajtohen MPEE:
 - peshore për të matur peshën e mbetjeve të trajtuara,
 - aty ku është e nevojshme, sipërfaqe/dysheme të papërshkueshme dhe mbulesa/tavane për tu mbrojtur nga uji që shoqërohen edhe me paisje për kapjen dhe grumbullimin e shkarkimeve/pikimeve aksidentale dhe sipas rastit edhe me paisje dekantuese, pastruese - sgrasatuese,
 - vend të përshtatshëm për magazinimin e pjesëve të kembimit të çmontuara,
 - konteinerë të përshtatshëm për magazinimin e baterive, të kondensatorëve që përmbajnë PCB- /PCT dhe mbetje të tjera të rrezikshme, si psh. mbetjet radioaktive,
 - pajisje për trajtimin e ujit në përputhje me legjislacionin për shëndetin dhe mjedisin.

ANEKSI IV

Simboli për markimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike

Simboli që tregon grumbullimin veçmas të pajisjeve elektrike dhe elektronike përmban një kosh me një kryq mbi të, sic tregohet më poshtë. Simboli printohet në mënyrë të tillë që të jetë i dukshëm, i lexueshëm dhe që nuk mund të shqitet.



Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 5.4.2013
Doli nga shtypi më 5.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 42 lekë

